

ZIHNI SAKO

BALLADA SHQIPTARE PËR MURIMIN DHE ELEMENTET E SAJ TË PËRBASHKËTA ME MOTËRZIMET BALLKANIKE

Dihet se flijimi i njeriut është një ritual, që formon nyjën kryesore të subjektit të balladës së «murimit», i cili ka në përgjithësi karakter inaugural drejtuar kundër shpirtrave keqbërës.

Tregimi i Herodotit se Kserksi, kur kapi anijen «Trezen» të Praksi- mit, i preu kokën marinarit më të bukur dhe pastaj nisi lundrimin e parë të saj, na shpjegon qartë se në këtë rast flijimi i njeriut kryhet me qëllim që ky të bëhet roje në dobi të lundrimit të mbarë të anijes. Ky rit është i njohur në shumë vise. Kinezët, fjala vjen, në themelet presin një gjel, i cili, duke qenë se mbahet si lajmëtari i agimit, pra si shpend «diellor», tremb shpirtrat keqbërës. Edhe në Japoni njeriu varrosej i gjallë ndën ura e kështjella për të marrë me të mirë perënditë, të cilat do të ndihmonin në qëndrueshmërinë e ndërtimeve, ashtu si u flijua Abirani, i biri i madh i Akielit, në themelet e mureve të qytetit Jeriko gjatë rindërtimit të tij.

Por në këta popuj, si edhe ndër të tjerë, ky veprim ka mbetur ashtu siç ka qenë, një paragjykim magjik, kurse ndër popujt e Ballkanit ai i ka dhënë shkas krijimit të një ballade fort të bukur e të pasur në motërzime.

Ndër popujt e Ballkanit dhe të Azisë së Vogël kjo balladë tregohet për kështjella, ura, kisha e manastire, nga të cilat ajo për ura është më e përhapura. Ballada për murimin tregohet në të gjithë territorin e Evropës Juglindore: në Shqipëri, Greqi, Bullgari, Rumani, e Serbi, duke arritur deri në Turqi (Adana). Nga motërzimet e shumta të kësaj ballade, ajo për kalanë e Shkodrës, për urën e Artës e manastirin e Argëshit kanë një popullaritet të madh jo vetëm për bukurinë e shtjellimit të tyre, po se studionjës të ndryshëm këto i kanë marrë si kryesore për studim përgjithësimi dhe krahasimi.

Në këtë artikull nuk kemi në mend të japim një pasqyrë të hollësishme të kufive të shtrirjes, apo të numrit të zotërimeve. Do të meremi kryesisht me veçoritë shqiptare, me elementet e përbashkëta ndërballkanike dhe vendburimin.

Kërkimet shqiptare për balladën e murimit kanë nisur qysh në vitet 1868-1878 nga Thimi Mitkua (Bleta Shqiptare). Më pas këto kërkime u zgjeruan dhe deri në vitin 1965, janë regjistruar tekste (nga të cilat: 22 inçizuar: 19 për kala dhe 13 për ura) në 150 qendra të banuara. Nga analiza e këtyre teksteve rezulton se ballada në fjalë shtjellohet më tepër për kala dhe ura, ndërsa numri i balladave për kisha është relativisht i vogël. Në motërzimet e zonave veriore në qendrën e vëmendjes është Kalaja e Shkodrës. Po, përveç Kalasë së Shkodrës ka edhe tri kala të tjera shqiptare, për të cilat tregohet ballada: Kalaja e Turrës midis Kavajës e Divjakës, Kalaja e Petro Petroshit në Lleshan të luginës së Shkumbinit dhe Kalaja e Elbasanit.

Megjithkëtë ballada e murimit për Kalanë e Shkodrës ka një përhapje të gjerë, që nis nga Alpet e Shqipërisë Veriperëndimore e Verilindore e zbret deri në zonat fushore të brigjeve të Shkumbinit, kurse subjekti i përgjithshëm i murimit si edhe motivi i thyerjes së besës nga të dy vëllezërit e mëdhenj është i përhapur për urën edhe në zonat juglindore e për kala edhe në zonat fushore afër bregdetit si në rastin e Kalasë së Turrës.

1 — Elemente të veçanta dhe të përbashkëta ndërballkanike.

Njihet se ballada për murimin, në vise të Evropës Juglindore ka një pikënisje të përbashkët: tre ose disa ustallarë ndërtojnë ditën muret e një kalaje, o kishe, o këmbët e një ure, dhe natën u rrëzohen.

Që të qëndrojnë muret, duhet vendosur e gjallë një grua. Subjekti që përbën nyjën kryesore të balladës, është i përbashkët si për kalanë e Shkodrës, ashtu për Urën e Artës, Adanasë, për Manastirin e Argëshit, për balladën serbe dhe bullgare, për Urën e Strumës etj. Në këtë subjekt gërshetohet lait-motivi i unazës, që gjoja i ka rënë kryemjeshtrit, ose vëllait të vogël në themel dhe kur grua zbret për ta kërkuar, e mbulojnë.

Këto çështje, pothuaj të përbashkëta për të gjitha motërzimet ballkanike, të cilat përbëjnë tërësinë e subjektit të balladës, nëpër shekuj kanë përfutur disa elemente të veçanta, me anën e të cilave dallohen nga njëratjetra, ose plotësojnë njëratjetrën. Në këtë mënyrë ato kanë veçori kombëtare. Kështu në drejtim të ononimisë në balladën shqiptare të Shpatit të Elbasanit nusja e vogël quhet «Zarë», në atë mirditoren «Gjina Vida», në Malësinë e Madhe, Shkodër, vëllai i vogël quhet «Baca Gjergji», i biri, në një motërsim nga Dukagjini, «Miri», në Opar (zonë juglindore) Tefik. Në balladën serbe, për kalanë, arqitekti i ndërtimit quhet «Rada», në rumunen kryemjeshtri quhet «Manoli», ose «Kelemen», në bullgaren nusja e vogël «Struna».

Ballada shqiptare për kalanë e Shkodrës është e pasur edhe për toponiminë, që gërshetohet konkretisht me territorin rreth kështjellës: «Kazenë», «Maldunus», ose «Valdanus» (kodra mbi të cilën ngrihet Rozafati), Zarufë. Të tria këto ekzistojnë edhe sot; e dyta mund të jetë edhe një kalk me origjinë nga emri i portit: «Valdinoce» e periudhës së pushtimit venedikas.

Ballada për Urën e Artës e pasuron shtratin e përbashkët ndërballkanik me tri motra, që murosen njëra pas tjetrës; një në një urë mbi «Danub» një në urën e lumit «Afrat», një në Urën e «Artës»; ndërsa në atë që tregohet në ishullin Samos, njëra motër është murosur në Urën e «Gallatasë», tjetra në të «Mezirit» dhe e treta në Urën e Qimes; në atë të Nigritës (Maqedoni) një në «Ternavo» (Bullgari), një në një urë në «Belgrad» dhe një në «Lars» (Larisa). Si shihet ballada greke ka një pasuri toponimike e cila na dëftën, njëherësh edhe përhapjen e saj të gjerë.

Zakonisht, mënyrën ose mundësinë se qysh mund të qëndrojnë muret, ustallarëve u a rëfen një njeri «i shenjtë» (për Rozafatin), ose një «zog» (për urën e Artës). Po me balladën shqiptare elementi ndërballkanik pasurohet edhe me një element tjetër. Në një motërzim nga Prilepnica (Kosovë) nusja e tretë paska parë ëndër që ajo do të murosset.

Në balladën shqiptare flitet qartë për një nga virtytet më të larta të popullit shqiptar «besën» e përmendur, të cilën e përfaqëson denjësisht vëllai i vogël. Ky element është unik dhe balladën e pasurën në një shkallë më të lartë.

Dihet se krijimtaria popullore lot një rol tepër të rëndësishëm në historinë e një populli, në forcimin e ndërgjegjes patriotike, për të përballuar rreziqet e pushtimit të të huajve dhe për të luftuar për drejtësi shoqërore kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Për këtë arsye shpeshherë, në krijimet artistike popullore, ndeshim pasqyrime të një realiteti konkret historik. Ballada shqiptare për murimin ka fituar elemente edhe të një periudhe të caktuar historike, pikërisht të kohës së pushtimit turk. Në balladën dukagjinase, gruaja që muroset, u drejton ustallarëve këtë thirrje kuptimplote:

Për nj'atë ditë që djali e lshoftë,
Daltë Turku e u zaptoftë;
Biftë ferra e e mbloftë,
Gjofti rrfeja e e shpartalloftë.

Kështu edhe pse ballada në tërësinë e saj ka një sfond elegjiak, ngjarja është e dhimbshme dhe gratë që murosen, quhen «fatkeqe», ajo ka përfutur një pamje liriko-epike.

Zakoni i murosjes së gruas ka qenë i egër, po ai, siç dihet, shkallë-shkallë kaloi në flijimin e bagëtive e të shpendve. Megjithkëtë ai jetoi në një trajtë tjetër, njeriu i gjallë u zëvendësua me murimin e «hijes së tij». Ky zakon i ri duket se edhe në Shqipëri ka qenë i njohur deri vonë. Për ndërtimin e njerës këmbë të Urës së Gjirokastrës, mbi Drino, në rindërtimin e saj, në gjysmën e dytë të shekullit XIX tregojnë se kanë murosur një fill pe në masën e një trupit të një njeriu të sëmurë. Në Urën e Beratit, mbi Osum, kanë murosur një bust druri të një vajze të re. Njerëzit edhe kësaj praktike i janë ruajtur, siç tregon proverbi: «ai i trembet hijes së vet», gjykim me të cilin populli përcakton frikacakun.

Te bullgarët «hija e njeriut» matej me një litar, të cilin e mbyllnin në një kuti dhe e vendosnin në themel. Rumunët e Transilvanisë kanë bërë edhe tregëti, duke shitur hijen.

Po sidoqoftë, zakoni kaloi në një bestytini të theksuar dhe ka ushtruar një ndikim të madh në ndërgjegjen e njerëzve, shkelja e tij konsiderohej sakrilegj, që sillte gjoja, pas ndërtimit të shtëpisë së re, vdekjen e të parit të shtëpisë.

Megjithkëtë edhe në qëndrimin e të murosurës variantet ballkanike kanë veçori që dallohen midis tyre, me të cilat e pasurojnë edhe në këtë drejtim akoma më shumë vijën e saj kryesore.

Në balladën shqiptare, nusja e vogël mban një qëndrim stoik, i cili harmonizohet me qëndrimin e saj të sjellshëm kur i thotë e vjerra t'u çojë bukën djemve që punojnë në kala. Stoicizmi dhe kërkesat e saj për t'i lënë jashtë syrin e dorën e djathtë, këmbën dhe gjirin e djathtë, që kur të qajë i biri:

me njan' sy ta shikojë,
me njan' dorë ta lëmojë,
me njan' kambë ta lurtojë,
me njan' gji ta nërgojë...

i japin tregimit karakterin liriko-elegjak, i cili, siç e përmendëm më lart, zgjerohet në një sfond epik, që përputhet plotësisht me ndjenjën patriotike popullore. Ajo edhe pse na dhimbset, si një viktimë e një zakoni tepër të egër, na qëndron përpara syve tanë si kalaja që ndërtohet sipër trupit të saj.

Në balladën greke gruaja që hyn brenda në themel për të kërkuar «unazën», futet në mënyrë tepër naive. Për fatkeqësinë që e gjen, shkrehet në një vajtim të dhimbshëm, po që më pas kalon në një zëmrim, në një mallkim tronditës për ustallarët.

Ky element, tepër interesant, e plotëson balladën edhe me një karakter shoqëror të periudhës fisnore. Ustallarët, duke i u trembur mallkimit, i luten të shoqes së kryemjeshtrit, ta heqë mallkimin për t'u lëkundur ura, se mund të kalojë mbi këtë urë edhe vëllai i saj, që ndodhet në mërgim. Atëhere asaj i dhimbset i vëllai dhe e kthen mallkimin në një sakrificë të pranuar vullnetarisht për dashurinë e saj si motër për vëllanë.

Thamë se ballada ka karakter ritual. Ky karakter përforcohet edhe me ritet për qumështin e gjirit të lehonave. Gratë tek ne kishin zakon që kur u mungonte qumështi, pasi hanin bukë e qepë, lyenin, në mëngjes herët sapo lindte dielli, thithët me ujë gëlqëror të harqeve ose kubeve të kalave. Ky ujë i bardhë, besonin, ishte qumështi i të murosurës, pra riti konsiderohet si burim jete.

2 — Mbi vendburimin kryesor.

Njihen mirë punimet e veçanta për burimet dhe vjetërsinë e kësaj ballade, bërë nga K. Schladebach dhe veçanërisht nga K. Dietrich, L. Saineanu, Baud-Bovery, Stefanoviç, Skok, Sandfeld, Cocchiarra, Arnaudov, Vargyas. Po si këta studjonjës ashtu edhe të tjerë që janë marrë me këtë balladë, nga mungesa e njohurive të balladës shqiptare rreth murimit për kalanë e Shkodrës etj. janë mbështetur vetëm te teksti serbisht «Grad gradili na Skadar» botuar nga Vuk Karaxhiçi, ose motërzimet e tjera serbe, në atë rumunen për Manastirin e Argëshit dhe sidomos në atë greken për Urën e Artës. Prandaj ata kanë qenë, me gjithë kontributin e tyre të çmuar në studimin e balladës, tepër të kufizuar dhe të njëanshëm për të dhënë një gjykim më të drejtë dhe më të plotë.

Studimet e tyre u kufizuan në tekstin serb për Kalanë e Shkodrës, në rumunin, botuar më 1866 nga V. Aleksandri në vëllimin «Poezi i populare» nr. 40, edhe në botimin e balladës greke për Urën e Artës botuar në fund të shekullit XIX. Kështu këto duke qenë botuar përpara balladës në shqip patën prioritet në rrethet shkencore. Po në shqip specimenet e para u botuan më 1878 në «Bleta Shqiptare» nga Thimi Mitkua: një në poezi dhe një në prozë. Kërkimet e tjera folklorike në Shqipëri filluan gjatë periudhës së pavarësisë, veçanërisht pas çlirimit. Nga këto kërkime u grumbulluan, siç e përmendëm më lart, një numër i konsiderueshëm tekstesh edhe për këtë balladë. Në numrin e math të saj ne vërejmë se kjo balladë ka gjetur një përhapje të gjerë në Shqipëri e në Kosovë. Prandaj mendojmë se studimet e deritanishme, duke mos pasur njohuri edhe në këtë numër të motërzimeve shqiptare, nuk mund të jenë të plota edhe për vendburimin, edhe për vjetërsinë.

Deri më sot prioriteti i është dhënë balladës për Urën e Artës dhe ky prioritet mbështetet në numrin e madh të teksteve dhe se në motërzimet e tjera greke flitet për një përhapje tokësore, nga motivi i të tre motrave, jashtë kufive greke. Për origjinën greke është shprehur dijetari i njohur N. Politis, e këto vitet e fundit italiani G. Cocchiara (1950). Kurse hungarezi Lajos Vargyas (1960) shprehet për një origjinë kaukazike.

Na duket se mbështetja për të argumentuar prioritetin vetëm nga këto dy çështje nuk mund të jetë e plotë. Ballada e ka burimin në një rit tepër të vjetër, që shtyhet shumë përpara viteve 527-565 pas erës së re, kur u ndërtua Ura e Adanasë dhe ku u muros një njeri: aq më shumë përpara Urës së Artës që u ndërtua midis viteve 1602-1606, ose Urës së Agraidhës ndërtuar më 1659 nga ustallarët Marrolis dhe Dhimitrios.

Ne mendojmë se burimi është ilirik dhe se referimi më i parë në Ballkan duhet të jetë për Kalanë e Shkodrës «Rozafatin». Humanisti dhe historicografi shqiptar Marin Barleti në veprën «De obsidionis Scodrensi», Venetiae 1505, na flet se për kalanë e Shkodrës tregohej edhe në kohë të tij një legjendë dhe se atë e kanë ndërtuar një vëlla e një motër (Roza dhe Fa - Rozafa). Pavarësisht nga mjergulla që mbulon ngjarjen, për saktësinë historike të ndërtimit të kalasë së Rozafatit, këtu na intereson, për mendimin tonë, fakti se tregimi është më i hershëm se ai për urën e Artës.

Shkodra ka qenë një qendër e rëndësishme e ilirëve dy-tre shekuj përpara erës së re, pra, përpara ndërtimit edhe të Urës së Adanasë. Si qendër ekonomike dhe ushtarake, patjetër, ajo ka ushtruar ndikim të madh si në fiset e tjera ilire, ashtu edhe në popujt e tjerë që e pushtuan, veçanërisht në periudhën e pushtimit skllav. Prandaj, është e kuptueshme, që edhe vetë pushtonjësit sllavë, për të përjetësuar sundimin dhe ndikimin e tyre, i kushtuan një vëmendje të veçantë qytetit të Shkodrës dhe kalasë së saj sa që u shprehën se atë e kanë ndërtuar vëllezërit Vukashin, Ugliosha dhe Gojko, të cilët kanë sunduar në shek. XIV viset veriperëndimore dhe verilindore të Shqipërisë. Pa dyshim ballada është shprehur në mënyrë poetike më vonë, po burimi i subjektit është i hershëm, se, siç e pamë, edhe flijimi njerëzor është shumë i hershëm.

Zbulimet arkeologjike të viteve të fundit në qytezën e Gajtanit, tregojnë se kjo qytezë ka ekzistuar qysh në shek. VII dhe se në shek. III ka pasur një lulëzim të ndjeshëm. Në muret mbrojtëse të qytezës, banorët ilirë kanë kryer flijime për perënditë. Varrezat e këtyre flijimeve, në trajtë të një rrethi diellor vendoseshin në këto mure mbrojtëse. Në këtë mënyrë këtu kemi të bëjmë me një rit, me një kult të diellit, paraqitur me rrathë gurësh. Në këtë vijë mbrojtëse janë gjendur vazo me kocka fëmijësh.

Këto të dhëna për flijime njerëzore në muret mbrojtëse të një qyteze dhe pikërisht në afërsitë e Shkodrës, duhen pasur parasysh për ndikimin e tyre në legjendën e balladës së murimit për Rozafatin e Shkodrës.

Nga ana tjetër, zbulimet e tjera arkeologjike edhe këto të kohëve të fundit në vise të jugut të tejmë të Shqipërisë, kanë treguar në mënyrë bindëse se edhe këtu ka qenë tokë e banorëve thjesht ilirë, duke hedhur kështu poshtë mendimin se ilirët kishin si kufi të fundit Shkumbinin. Territori i ashtuquajtur «Ipiros» bënte pra pjesë në bashkësinë e fiseve ilire që shtriheshin, siç dihet, në një territor të gjerë,

banorët e të cilit: bilinët, amantët, kaonët, mallosët, thesprotët etj., siç thonë edhe vetë historianët grekë, si Turiqididhi, grekrit i kanë quajtur «barbares», sepse s'flisnin gjuhën greke. Në këto zona greqishtja u përdor si gjuhë vonë. Prandaj edhe territori ku është ngrihur Ura e Artës është një vendbanim ilirjan.

Arta, përpara ndërtimit të Urës (1602-1606), për të cilën tregohet ballada, ka qenë territor me një popullatë të madhe shqiptare. Ngjarjet historike të dy-tre shekujve më parë, kur më 1374, pas vdekjes së Pjetër Loshës, nga Mazaraku - Mareku i Çamërisë - Gjin Bua Shpata, si dëboi të birin e Pjetrit, pati në principatën e vet edhe Artën të cilën pas vdekjes së këtij më 28 Prill 1400 e trashëgoi Zgura. Ajo që ka rëndësi është fakti se s'ishin vetëm zotëronjësit e këtij territori shqiptarë, po se kemi të bëjmë me një popullatë masive shqiptare, veçanërisht fusharake. Dokumentimet e mësipërme na flasin qartë.

Pra nga numri i motërzimeve të balladës shqiptare, të cilat tregojnë, tek ne, një përhapje mjaft të gjerë të saj, si për kala ashtu edhe për ura, nga numri i kalave për të cilat tregohet ballada, nga argumentat historike dhe nga se ballada i referohet kalasë së një qyteti ilirjan dhe urës së një qyteti me një popullatë të gjerë shqiptare në shek. XIV, na duket se burimi i parë i subjektit të balladës është Iliria, pra Shqipëria.

Bibliografia:

- 1) Thimi Mitko: Bleta Shqiptare - 1878
- 2) Qemal Haxhihasani: Këngë legjendare - 1955
- 3) Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar I-II-III, 1961-1962
- 4) Histori e Shqipërisë - V. I. 1959
- 5) Alfred Loisy - Essai historique sur le sacrifice, Paris 1920.
- 6) Tragudhja tu heleniku laou - Athinë 1952.
- 7) Lacgrafia: tom V fash. A. - Athinë 1966
- 8) Helenika demotika tragudhja V. I - Athinë 1962
- 9) Bep Rebani: rev. Ylli Nr. 2, shkurt 1966 f. 33 dhe Studime historike 1 - 1966, f. 41-81.

RESUME

ELEMENTS BALKANIQUES COMMUNS DANS LE RITE DE LA BALLADE DE L'EMMUREMENT

On sait que le sacrifice humain représente un rite qui constitue la trame principale de la Ballade de l'Emmurement. Ce rite, pratiqué dans les fondations des châteaux, des ponts et des églises, e eu en général un caractère conjuration contre les esprits démoniaques. Le sujet est commun pour les contrées du Sud-Est européen.

En Albanie, cette ballade compte une infinité de variantes et une diffusion des plus amples depuis le massif de l'Albanie du N.-O et du N.-E, jusq'aux basses des berges du Shkumbin. Le motif de la rupture de la parole donnée par les deux grands frères pour la construction du pont trouve son extension aussi dans les zones du S.-E., et, pour le château, dans les zones basses du littoral.

Examinant le particulier et le commun dans ces éléments balkaniques l'auteur fait observer que le sujet, qui forme la trame principale, est connu aussi bien au château de Shkodër, qu'au pont d'Arta, d'Adana, au monastère d'Arges, à la bolade serbe et bulgare, etc. L'oncmastique albanaise, pourtant, dans cette ballade est plus riche.

Généralement, le moyen ou la possibilité à faire résister les murs est indiquée aux maçons par un «saint» (pour le Rozafat), ou par un «oiseau» (rossingnot) pour le Pont d'Arta. Mais la ballade albanaise enrichit ce répertoire par un nouvel élément: l'épouse a vu en songe qu'elle sera emmurée. La ballade albanaise offre également plusieurs autres éléments de la période de la domination ottomane, rejoignant ainsi une expression lyrico-épique de résistance aux envahisseurs.

On sait, qu'avec le temps, au lieu du sacrifice humain on a passé au sacrifice de bétail, il y aussi la substitution par «l'ombre». A Gjirrokastër on ensevelissait un fil à la mesure d'un homme melade, et sur le pont de l'Osum a Berat on a l'autre coutume d'ensevelir un mannequin. Le coutume de l'ombre se retrouve aussi en Bulgarie et en Roumanie comme vestige.

La question du foyer principal de cette ballade a donné lieu à plusieurs travaux, dont Schladebach, Dietrich, Saineanu, Baud-Bodery, Stefanovic, Skok, Sandfeld, Cocchiara, Vargyas. La priorité du foyer et de l'ancienneté a été reconnue jusqu'à maintenant à la version du Pont d'Arta, en se basant notamment sur le grand nombre de textes et sur la diffusion du motif des trois soeurs.

A l'avis de Sako, la ballade tire son origine d'un rite très ancien, qui remonte bien avant les années 527-565 de l'ère nouvelle, quand fut construit le pont d'Adana où fut emmuré un homme. Il lui argumente une source illyrienne, et la première signalation dans les Balkans doit être pour le château fort de Shkodër, le Rozafat. Cela est argumenté par la mise au jour, dans l'enceinte de la citadella de Gajtan, au voisinage du Shkodër, qui remonte au III^e siècle de notre ère, de sépultures de ces sacrifices humains, sous forme de cercle solaire, qui se situent précisément sur cette enceinte défensive. On est donc en présence d'un élément rituel du culte du soleil, représenté par des cercles de pierres. Dans cette ligne défensive on a trouvé aussi des urnes avec quelques os d'enfants.

Compte tenu de ces données sur le sacrifice humain dans l'enceinte d'une cité, et précisément au voisinage immédiat de Shkodër, on doit absolument avoir présente aussi leur influence sensible sur la légende de la Ballade de l'Emmurement de Rozafat à Shkodër.

En partant donc du nombre de variantes de la ballade albanaise, qui indiquent sa grande diffusion, aussi bien pour les châteaux que pour les ponts; du nombre des châteaux sur lesquels parle la ballade; des arguments historiques confirmant que la ballade a affaire précisément au château d'une ville illyrienne et au pont d'une ville, on est ponché à fixer le foyer principal du sujet dans l'Illyrie.

